

VENDIM
Nr. 889, datë 11.11.2020

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 82, DATË 14.2.2018, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NGARKIMIN E AGJENCISË SË BLERJEVE TË
PËRQENDRUARA PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE
DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në fund të fjalisë së nënpikës 1.2, të pikës 1, shtohen fjalët “... dhe karburantit që prokurohet për përdorim nga fermerët”.

2. Pas pikës 2 shtohet nënpika 2.3, me këtë përmbajtje:

“2.3 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural t’i realizojë vetë procedurat e prokurimit për blerjen dhe shpërndarjen e karburantit, që prokurohet për përdorim nga fermerët në sektorin e bujqësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe